

RELACION TEKNIK

**PËR OBJEKTIN “RIKONSTRUKSION I RRUGËS AUTOMOBILISTIKE NE
FSHATIN DUFSHAN”
(SEGMENTI DUFSHAN-TRASHOVICE)**

NJ.A SULT, BASHKIA GRAMSH

Gramsh, 2018

RELACION TEKNIK

PËR OBJEKTIN “RIKONSTRUKSION I RRUGËS AUTOMOBILISTIKE NE FSHATIN DUFSHAN”

NJ.A SULT, BASHKIA GRAMSH

Rruga automobilistike ne fshatin Dufshan eshte ndertuar dhe eshte vene ne shfrytezim rreth viteve '70.

Ne prioritetet e miratuara nga Keshilli i Bashkise Gramsh, per vitin 2019, eshte perfshire edhe Rikonstruksioni i rruges automobilistike ne fshatin Dufshan, Njesia Administrative Sult, Bashkia Gramsh, me nje fond prej 2 000 000 leke.

Nder vite ne kete rruge jane bere investime te pakta, kryesisht shtresa zhavorri, kanale anesore, si dhe sherbime te mirembajtjes.

Vitet e fundit ky segment rrugor eshte bere teper problematik per qarkullimin e mjeteve, per shkak te amortizimit te rruges, ku nder problemet kryesore paraqiten: mungesa apo bllokimi i kanaleve, shtresat e rruges te demtuara, dhe tombino ekzistuese te demtuara apo te shembura.

Nga shirat e rena ne vitet dhe kohet e fundit, gjendja e kesaj rruge eshte perkeqesuar edhe me teper dhe konkretisht problemet paraqiten si me poshte:


Rruga ne tere gjatesine e saj eshte me shtresa zhavorri te demtuar me gropezime te shkaktuara nga ujrat qe rrjedhin ne rruge, prej kanaleve te bllokuara apo qe mungojne dhe kerkohet qe keto kanale te hapen dhe tombinot te rikonstruktohen ne menyre qe rruga te mirembahet dhe te mos degradohet plotesisht.

Kanalet anesore jane te bllokuara pjeserisht dhe ne disa raste edhe totalisht, keshtu qe ne te gjithe gjatesine e rruges duhet te nderhyhet per pastrimin e atyre ekzistuese dhe hapjen e kanaleve anesore te reja atje ku ato mungojne.

Shum tombino betoni jane te bllokuara dhe te shembura, bashke me muret mbajtes, si dhe nga ngopja e dherave me uje rrezikohet shembja totale e trupit te rruges. Gjithashtu dhe pusetat duhen pastruar dhe ne disa raste kane nevoje edhe per meremetim, si dhe te ndertohen

te reja atje ku mungojne.

Ne keto kushte, eshte e nevojshme te kryhen nderhyrje te menjehershme ne rikonstrukcionin mureve mbajtese, tombinove te prishura, demtara apo te bllokuara, zgjerimin e rruges atje ku eshte e nevojshme, largimin e dherave te rena ne rruge si dhe nderhyrje per hapjen e kanaleve kulluese dhe permiresimin e shtreses se rruges me zhavorr. Ky investim do te permiresoje infrastrukturen rrugore lidhese ndermjet fshatit Dufshan dhe Njesise Administrative Sult, si dhe lidhjen e ketij fshati me Bashkine Gramsh dhe me rrugen kryesore Gramsh – Elbasan.



Punimet ne kete objekt jane parashikuar te zhvillohen ne harkun kohor prej 40 ditesh, duke plotesuar te gjitha zerat e parashikuar ne preventiv, sipas grafikut te punimeve te ketij projekti.

Me realizimin e ketij investimi sipas projektit te rikonstrukcionit, mendojme se kjo rruge do te plotesoje kushtet normale per qarkullimin e mjeteve e te komunitetit ne kete zone.

Per sa me siper hartohet ky relacion teknik.

HARTOI

ING. DHORI NISHKU